

# **NJOFTIMI I MODIFIKIMIT TË KONTRATËS GJATË KOHËZGJATJES SË SAJ**

## **BASHKIA DIVJAKË**

NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË  
ZBATIMIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Emri Bashkia Divjakë  
Adresa Lagjia nr.2  
Tel/Faks 0371 22081  
E-mail info@bashkiadivjake.gov.al  
Ueb-faqe www.bashkiadivjake.gov.al

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri Vojsava Leçini  
E-mail vojsavalecini@bashkiadivjake.gov.al

3. Lloji i procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”

4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes Kuadër: Mallra.

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: REF-58243-08-15-2025

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje mjetesesh për nevojat e Bashkisë Divjakë dhe Agjencisë së Shërbimeve Komunale”, (autobot uji për pastrimin e ujrave të zeza, trajler për transport mbetjesh urbane, autobot uji për larjen e qytetit, makinë me kosh, autoveturë e përdorur, makinë për Policinë Bashkiake dhe makinë teknologjike për mbetjet e re)”

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): (CPV): 34100000-8 Automjete, (CPV): 34111200-0 Vetura, (CPV): 34144511-3 Automjetet për mbledhjen e mbeturinave.

8. Fondi limit: 36,256,000 (tridhjetë e gjashtë milion e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa Tvsh, nga të cilat:

-25,474,382 (njëzetë e pesë milion e katërqind e shtatëdhjetë e katër mijë e treqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa Tvsh nga Granti, nga të cilat 21,007,715 (njëzetë e një milion e shtatë mijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa Tvsh nga Granti për vitin 2025, 3,135,833 (tre milion e njëqind e tridhjetë e pesë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) lekë pa Tvsh për vitin 2026 dhe 1,330,834 (një milion e treqind e tridhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e katër) lekë pa Tvsh nga Granti për vitin 2027.

- 10,781,618 (dhjetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa Tvsh nga Të ardhurat.

Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është: 372 927.38 (Treqind e shtatëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e njëzet e shtatë pikë tridhjetë e tetë) euro pa Tvsh.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 15.08.2025 është: 97.22

Burimi i financimit: Granti + Të ardhurat e Bashkisë Divjakë.

9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë: Ky amendament kontrate, lidhet bazuar në Nenin 127 pika 1 shkronja “c” të Ligjit Nr.162 datë 23/12/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në Nenin 107 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në zbatim të Nenit 8, 9, 25, 26, 27 të kontratës me me Nr.8207/16 Prot, datë 03.11.2025, në shkresën me Nr. 2088 Prot., datë 05.03.2026, “Kërkesë për shtyrje afati të dorëzimit të mallrave”, protokolluar pranë institucionit tonë me Nr. 1836 Prot., datë 05.03.2026, si edhe në relacionin teknik me Nr.1840 Prot, datë 06.03.2026, të paraqitur nga ana e grupit të punës për ecurinë e zbatimit të kontratës dhe marrjen në dorëzim të mallit.

Shkak i kërkesës për shtyerjen e afatit të kontratës, është;

1. Sipas njoftimit zyrtar të operatorit ekonomik “ALMETA GMBH” SHPK, vonesa në lëvrimin e këtij mjeti ka ardhur për shkak se nga ana e kompanisë prodhuese, operatori ekonomik është njoftuar se fabrika për shkak të problemit të ndodhur në sistemin elektrik ka punuar me kapacite të kufizuara dhe ka vonuar proceset e saj, për rrjedhojë është vonuar edhe prodhimi i mjetit “makinë teknologjike për mbetjet e re” dhe lëvrimi i tij.

Komisioni për ndjekjen e ecurisë së zbatimit të kontratës dhe marrjen në dorëzim të mallit, në zbatim të kontratës me objekt: “Blerje mjeteesh për nevojat e Bashkisë Divjakë dhe Agjencisë së Shërbimeve Komunale”, (autobot uji për pastrimin e ujrave të zeza, trajler për transport mbetjesh urbane, autobot uji për larjen e qytetit, makinë me kosh, autoveturë e përdorur, makinë për Policinë Bashkiake dhe makinë teknologjike për mbetjet e re)”, propozoi aprovimin e kërkesës për shtyrje të afatit të kontratës për një periudhë 30 (tridhjetë) ditë, konkretisht deri më datë 07.04.2026.

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e mallrave:

Modifikimi përsëri i kësaj kontrate është bërë me qëllim shtyerjen e afatit të dorëzimit të mallrave, dhe nuk sjell asnjë ndryshim në natyrën, sasinë dhe vlerën e mallrave të cilat mbeten të pandryshuara. Kushtet e kontratës bazë të nënshkruar me Nr.8207/16 Prot, datë 03.11.2025, janë të vlefshme edhe për këtë amendament kontrate.

11.Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër: 42,547,200 (dyzet e dy milion e pesëqind e dyzet e shtatë mijë e dyqind) lekë me Tvsh, nga të cilat:

- 30,431,259 (tridhjetë milion e katërqind e tridhjetë e një mijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë me Tvsh nga Granti, i ndarë në vite si mëposhtë:
  - Për vitin 2025: 25,107,258 (njëzet e pesë milion e njëqind e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë e tetë) lekë me Tvsh nga Granti;

- Për vitin 2026: 3,763,000 (tre milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë) lekë me Tvsh nga Granti;
- Për vitin 2027: 1,561,001 (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e një) lekë me Tvsh nga Granti;
- 12,115,941 (dymbëdhjetë milion e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet e një) lekë me Tvsh nga Të Ardhurat për vitin 2025.

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): Vlera e modifikimit të kontratës është 0 (zero) lekë.

13. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër: Kontrata bazë e nënshkruar me Nr.8207/16 Prot, datë 03.11.2025 është me afat 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga momenti i nënshkrimit të saj. Me Amendamentin Nr. 1 të nënshkruar më datë 31.12.2025 afati i kontratës është shtyrë me 30 (tridhjetë) ditë, duke e çuar afatin e përfundimit të kontratës në datën 02.02.2026. Si rrjedhojë afati total i kontratës pas Amendamentit Nr. 1 është 90 (nëntëdhjetë) ditë.

Me Amendamenti Nr. 2 të nënshkruar më datë 02.02.2026 afati i kontratës është shtyrë përsëri me 35 (tridhjetë e pesë) ditë, duke e çuar datën e re të përfundimit të kontratës më datë 09.03.2026. Si rrjedhojë afati total i kontratës pas Amendamentit Nr. 1 është 125 ditë (njëqind e njëzetë e pesë) ditë.

Me Amendamentin Nr. 3 të nënshkruar më datë 09.03.2026 afati i kontratës është shtyrë përsëri me 30 (tridhjetë) ditë të tjera, duke e çuar datën e re të përfundimit të kontratës më datë 07.04.2026.

Në përfundim, afati total i kësaj kontrate, pas shtyrjes me Amendamentin Nr. 1, Amendamentin Nr. 2 dhe Amendamentin Nr. 3 bëhet 155 ditë (njëqind e pesëdhjetë e pesë) ditë dhe përfundon më datë 07.04.2026.

Dhe afati i ri (nëse është rasti): Afati i përfundimit të kontratës, shtyhet deri në datën 07.04.2026. Amendamenti Nr. 3 për shtyrjen e afatit të kontratës është nënshkruar më datë 09.03.2026.

14. Emri dhe adresa e Operatorit/ëve Ekonomikë:

Emri "ALMETA GMBH" SHPK  
NIPT: K22013001U  
Adresa Tiranë, Marikaj.  
Kontaktet: Telefoni: 0686026444; E-mail: info@almeta.al

15. Data e nënshkrimit të modifikimit : Amendamenti Nr. 3 për shtyrjen e afatit të kontratës është nënshkruar më datë 09.03.2026.

16. Burimi i financimit: Granti + Të ardhurat e Bashkisë Divjakë.

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_